

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Emine Mustafa, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit A.K, për shkak të veprës penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolicore, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës, nga neni 3 par.3 të Ligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.619/2016 të datës 15.12.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.33/2018 të datës 19.04.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 06 nëntor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e prokurorit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.619/2016 të datës 15.12.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.33/2018 të datës 19.04.2018.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr. 619/2016 të datës 15.12.2017, në mungesë të provave e ka liruar nga akuza A.K, për shkak të veprës penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet

e jashtme paraushtarake ose parapolicore, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës nga neni 3 par.3 të Ligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit. Shpenzimet e procedurës penale janë ngarkuar buxhetit të kësaj gjykate.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.33/2018 të datës 19.04.2018, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës në Prishtinë, për shkak të shkeljes së ligjit penal me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të vendosë sipas detyrës zyrtare.

Mendimi i mbrojtësit

Mbrojtësi i A.K, av. A.Gj., me shkresën e datës 01.10.2018, ka propozuar që kërkesa e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohen aktgjykimet e kundërshtuara.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë pretendohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, i vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë, me të cilat i pandehuri është liruar nga akuza kanë lënë dyshime evidente se faktet relevante të argumentuara me prova konkrete nga ana e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, janë anashkaluar dhe nuk i është dhënë rëndësi për gjetjen fajtor të të pandehurit për veprën penale dhe kjo ka ndikuar që të shkelet ligji penal.

Pretendohet se provat bindëse që përfshinë periudhën e vitit 2016, siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës pa asnjë dyshim vërtetojnë faktin se i pandehuri është kryerës i kësaj vepre penale. Prandaj situata faktike reflekton dyshimin e konsiderueshëm se saktësia e këtyre fakteve relevante nuk është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe nga gjykata e shkallës së dytë dhe si rezultat i mos vërtetimit të secilit fakt relevant është nxjerr aktgjykim liruës dhe me këtë është bërë edhe shkelje e normës ligjore që i referohet nenit 3 par.3 të Ligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes nuk ka arsyetuar faktin se ndaj A.K, më parë ka qenë duke u zhvilluar edhe një procedurë penale dhe atë pikërisht për veprë të kësaj natyre dhe për këtë arsye gjatë vitit 2016 ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak sipas aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe si pasojë e faktit se disa herë nuk e ka respektuar këtë masë ndaj tij është lëshuar urdhër arrest. I njëjti ishte arratisur nga Kosova dhe kishte shkuar në Siri për t'iu bashkuar me grupet terroriste, kurse pas qëndrimit në Siri me disa persona të tjerë janë ndaluar nga ana e autoriteteve të Turqisë duke kaluar ilegalisht kufirin mes Sirisë dhe Turqisë në regionin Hatay. Pas zbatimit të procedurave standarde të depërtimit i njëjti u dorëzohet autoriteteve kosovare përmes aeroportit të Prishtinës. Andaj nuk është i bazuar qëndrimi i dy gjykatave se nuk është argumentuar rrethana se A.K i është bashkuar grupeve-formacioneve paraushtarake të përfshira në luftën e Sirisë në periudhën kohore prej muajit mars 2016 deri në muajin maj 2016, e kjo duke marrë parasysh se i njëjti kishte marrë pjesë edhe më parë në luftën civile në Siri gjatë periudhës kohore 2013-2014.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i prokurorit të shtetit është i pabazuar, ngase aktgjykimet e kundërshtuara, nuk përmbajnë shkelje të pretenduara të ligjit

penal. Në rastin konkret nuk është i bazuar pretendimi siç është theksuar në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë se gjykata e shkallës së parë ka shkelur ligjin penal duke e liruar të akuzuarin nga akuza për veprën penale të përcaktuar me dispozitën e nenit 3 par.3 të Ligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit. Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe duke u bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka konstatuar se në veprimet e A.K, nuk manifestohen elementet e figurës së veprës penale siç është pretenduar në aktakuzë.

Pretendimi i paraqitur në kërkesë që përmes faktit se ndaj të pandehurit është zhvilluar procedurë penale për veprë të kësaj natyre se gjatë periudhës kohore 2013-2016, kishte qëndruar në Siri dhe mbi këtë bazë të argumentohet edhe shkuarja e tij në Turqi me qëllim të bashkimit me grupe-formacione parashtarake të përfshira në luftën e Sirisë, është pretendim i pa argumentuar.

Gjykata e shkallës së parë në faqen e katërt të arsytimit të saj në mënyrë të drejtë ka potencuar faktin se pjesëmarrja e të pandehurit në konfliktin në Siri gjatë periudhës kohore 2013-2014, ndonëse ende pa një vendim të formës së prerë, në asnjë mënyrë nuk mund të paraqet bazë për vërtetimin e fajësisë për veprën penale sipas kësaj çështje, siç pretendohet nga ana e prokurorit të shtetit dhe për më tepër këto dy çështje penale edhe pse janë kundër të pandehurit të njëjtë megjithatë duhet trajtuar si çështje tërësisht të ndara dhe që asnjëra prej tyre të mos e prejjudikojnë epilogun e tyre.

Edhe pse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është paraqitur për shkak të shkeljes së ligjit penal, megjithatë bazuar në përmbajtjen e kërkesës, janë paraqitur pretendime për konstatimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mirëpo, këto pretendime nuk janë vlerësuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, meqë bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Po ashtu në kërkesë pretendohet se në aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe po ashtu edhe të gjykatës së shkallës së dytë, ka dyshim të konsiderueshëm lidhur me saktësinë e fakteve vendimtare e i cili pretendim sipas Gjykatës Supreme të Kosovës nuk është evidentuar pasi që në rastin konkret në mënyrë të saktë janë vërtetuar faktet vendimtare dhe me të drejtë

arsyet e dhëna nga gjykatat e instancave më të ulëta nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale në fjalë.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.237/2018, më 06 nëntor 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka